



ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 43, Datë 16.03.2022

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR KUALIFIKIMIN DHE PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGJINËS PËR IMPIANTIN E PRODHIMIT TË ENERJISE ELEKTRIKE “HEC MOGLICË”, TË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A. PËR VITIN 2020 DHE 2021

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3, gërma “ë” dhe nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 4, 6, 7 dhe 8, të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 229, datë 20.12.2019; dhe nenit 19, gërma “d”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.03.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 373 prot., datë 11.03.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për kualifikimin dhe pajisjen me certifikatë të garancisë së origjinës për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. për vitin 2020 dhe 2021”,

Konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 684 prot, datë 07.05.2020, shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me “Çertifikatën e garancisë së origjinës” (GO) për impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Moglicë”.
- Duke qenë se u konstatua se shoqëria nuk kishte përcaktuar periudhën për të cilën kërkon të pajiset me Certifikatën GO, me e-mailin zyrtar të datës 18.02.2022, i’u kërkuar shoqërisë të saktësojë periudhën së cilës i referohet kërkesa për pajisjen me Certifikatë GO për “HEC Moglicë”.
- Në përgjigje të kërkesës së ERE-s shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 262/ 2 prot., datë 02.03.2022, saktësoi periudhat për të cilat kërkon të pajiset me Certifikatë GO (viti 2020 dhe viti 2021).
- Në zbatim të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., rezulton tërësisht i plotësuar si më poshtë:
 - Aneksi 1. Format i aplikimit, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar tërësisht.**
 - Neni 7, pika 7.4, Kërkesa për lëshimin e garancisë së origjinës, gërmat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “ë”, “f”, “g”. **Plotësuar tërësisht.**

- Neni 7, pika 7.5 Dokumentacioni teknik, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar tërësisht.**
- Neni 8, Procedura teknike e kualifikimit, pikat 8.1, 8.2, 8.3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”. **Plotësuar tërësisht.**
- Në lidhje me parashikimin e nenit 8.4, dhe në kuptim të nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” pas fillimit të procedurës, do të vijohet me dërgimin e një shkrese drejtuar Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për të sqaruar/marrë informacion për sa nevojitet mbi sasi të neto të injektuara në rrjet nga “HEC Moglicë”, në mënyrë që më tej të specifikojmë saktësisht sasi të energjisë për secilin vit.
- HEC “Moglica” nuk ka qenë më parë i pajisur me GO dhe ky është aplikimi i parë i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a., për kualifikim dhe pajisjen me GO të HEC “Moglicë”, i cili ka filluar operimin më datë 06.04.2020 dhe është pajisur me Çertifikatë të Pranimit të Veprës (CPV) në datën 17.11.2020 (për këtë na ka vënë në dijeni edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 1292 prot., datë 12.07.2021, protokolluar në ERE me nr. 152/2 prot., datë 13.07.2021, me anë të së cilës ka bërë me dije se deri më datë 31.12.2020 janë pajisur me CPV edhe HEC “Moglicë” dhe “Banjë”, të shoqërisë Devoll Hydropower sh.a, për sa cituar që në këtë fazë përmbushen edhe kërkesat e neneve 4 dhe 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për kualifikimin dhe pajisjen me Certifikatë të Garancisë së Origjinës të impiantit prodhues të energjisë elektrike HEC “Moglicë”, të shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a. të prodhuar gjatë viteve 2020 dhe 2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI